

STATUT DHE AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “PAN’S MICROBREWERY” SHPK

KREU I

FORMA, EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Kjo Shoqëri do të jetë “Shoqëri Tregtare” e formës “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” (sh.p.k.).
- 1.2 Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin Shqiptar në fuqi, mbi bazën e Statutit të saj dhe normat e së drejtës ndërkombëtare.

NENI 2

EMRI TREGTAR I SHOQËRISË

- 2.1 Shoqëria do të quhet “**Pan’s Microbrewery**” SHPK. Administratori do të bëjë vulën e shoqërisë, duke pasyqruar të dhënat mbi Emrin, NIPT-in dhe adresën e saj.

NENI 3

SELIA

- 3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën “*Njësia bashkiake Nr 2, Rruga Aleksandër Moisiu, Zona Kadastrale 8120, Godina Nr 5, Kati 0, TIRANË*”.
- 3.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 4

KOHËZGJATJA

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në QKR për njohjen dhe regjistrimin si person juridik.

NENI 5

OBJEKTI I SHOQËRISË

5.1 Shoqëria ka për objekt të saj Prodhimin dhe tregtimin e birrës si dhe importin dhe eksportin e artikujve të ndryshëm për prodhimin e birrës.

5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

6.1 Kapitali i Themeltar fillestar është 5,000,000 (Pesë milion) Lekë, i ndarë në 4 pjesë, me vlerë nominale për secilën pjesë prej 1,250,000 lekë. Kapitali i Themeltar nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët që zotërojnë 100% (njëqind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:

- Z. Erion Petromilo, shtetas shqiptar, i lindur në Vlorë, më 16.06.1977, identifikuar me kartë identiteti me nr. 03434949 dhe numër personal H70616205H, i cili zotëron 25% (njëzetë e pesë për qind të kapitalit, me vlerë nominale prej 1,250,000);


- Z. Sokol Nasi, shtetas shqiptar, i lindur në Përmet, më 18.03.1987, identifikuar me kartë identiteti me nr. 034072761 dhe numër personal I70318015C, i cili zotëron 25% (njëzetë e pesë për qind të kapitalit, me vlerë nominale prej 1,250,000);

- Z. Spiro Semi, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë, më 29.05.1984, identifikuar me kartë identiteti me nr. 034793868 dhe numër personal I40529056C, i cili zotëron 25% (njëzetë e pesë për qind të kapitalit, me vlerë nominale prej 1,250,000);

- Z. Martin Bejleri, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë më 16.05.1980, identifikuar me kartë identiteti me nr. 034486692 dhe numër personal I00516062A, i cili zotëron 25% (njëzetë e pesë për qind të kapitalit, me vlerë nominale prej 1,250,000);

6.2 Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe çdo lloj valute tjetër në banka vendase, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

6.3 Pjesët e kapitalit (kuotat) mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, pas dhënies së aprovimit për kalimin nga Asambleja e Përgjithshme.



NENI 7
KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI

7.1 Në rast se një ortak humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmit persona që do ti njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria. Asnjë nga këto parashikime nuk çliron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

7.2 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës të një ortaku, do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotërues i kuotës.

NENI 8

ZMADHIMI I KAPITALIT

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 10.6 të këtij Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.

8.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.

8.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 9

ZVOGELIMI I KAPITALIT

9.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 10.6 të këtij Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

9.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 10

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimarrës i shoqërisë dhe ajo ushtron të gjitha kompetencat që ligji “Për shoqëritë tregtare” i njuh asamblesë së ortakëve.

10.2 Asambleja e Përgjithshme mund t’ja delegojë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej saj dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e një prokure.

10.3 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

10.4 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.

10.5 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

10.6 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të 3/4 të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

NENI 11

VENDIMET E ASAMBLESES SË PËRGJITHSHME

11.1 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare brenda dhe jashtë vendit.

11.2 Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë vendos:

- Mbi ndryshimin në Statutin e Shoqërisë;
- Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera;
- Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare;
- Mbi emërimin dhe shkarkimin e Administratorit.

NENI 12

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

12.1 Shoqëria administrohet nga administrator Z. Erion Petromilo, me numër personal H70616205H, i cili emërohet nga Asambleja e Përgjithshme, për një afat 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

12.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Statut i'a rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

12.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e

kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

12.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

12.5 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

NENI 13

PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT

13.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a) i përfundon mandati;
- b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj rradhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

KREU IV

KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

NENI 14

KONTROLLI FINANCIAR

14.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohe i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 15

VITI FINANCIAR

15.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo Viti.

NENI 16

BILANCI VIETOR

16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

16.2 Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

16.3 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gashhtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 17

DIVIDENDI

17.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

KREU V

PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM,

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

18.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 19

LIGJI I ZBATUESHËM

19.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 20


ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

20.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

1. Spiro SEMI
2. Martin BEJLERI
3. Sokol NASI
4. Erion PETROMILO


Spiro Semi
MARTIN BEJLERI
Sokol Naci
ERION PETROMILO

DATË 18.06.2021